



A.nr.167/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-Kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari—anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.167/2026, të datës 13.02.2026, të parashtruar nga ankuesja D.T-H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria për Komunitete dhe Kthim, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.167/2026, e datës 13.02.2026, e parashtruar nga ankuesja D.T-H.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, D.T-H (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), me datë 13.02.2026, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos caktimit si ushtruese e detyrës në pozitën Drejtor i Departamentit për Hartim të Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik të Komuniteteve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria për Komunitete dhe Kthim, ndërsa, kjo e fundit më datë 27.02.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është e palejuar, *sepse*:

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.8/2025, të datës 01.08.2025, mbanë pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Ekonomik të Komuniteteve në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
- Sipas Vendimit me numër protokolli 146 të datës 11.03.2024, Vendimit me numër protokolli 146/2 të datës 11.02.2024 dhe Vendimit me numër protokolli 146/3 të datës 12.09.2024, të u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ankuesja ishte caktuar ushtruese e detyrës së Drejtorit të Departamentit për Politika dhe Analiza në këtë ministri dhe atë nga data 11.03.2024 deri më datë 11.03.2025, ndërsa, sipas emailit të datës 11.03.2025, ankuesja është njoftuar nga Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore se duke qenë se këtë pozitë e keni mbajtur si ushtrues detyrës gjashtë (6) plus gjashtë (6) muaj, është plotësuar afati një vjeçar, sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që, nga data 12.03.2025, ktheheni në pozitën sipas akt emërimit.
- Ankuesja më datë 15.12.2025, ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 3735, tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, duke kërkuar që të caktohet ushtruese e detyrës së Drejtorit të Departamentit për Hartimin e Politikave dhe Zhvillim Ekonomik të Komuniteteve, pasi sipas Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, janë plotësuar kushtet ligjore që të caktohem ushtrues detyre, mirëpo, sipas shkresave të lëndës ankuesja nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e saj të datës 15.12.2025.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër kërkesës se saj të datës 15.12.2025, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nuk ka nxjerr katin administrativ sipas legjislacionit përkatës dhe kemi miratim në heshtje; Pretendon se pozita është e lirë dhe plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Kërkon aprovimin e ankesës; të caktohet ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit për Hartimin e Politikave dhe Zhvillimi Ekonomik të Komuniteteve, kompensimin e diferencës së pagës sipas pozitës ushtrues detyre e Drejtorit të Departamentit për Hartimin e Politikave dhe Zhvillimi Ekonomik të Komuniteteve nga data 12.03.2025 deri në marrje të vendimit.

III. Vlerësimi i çështjes

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se: “Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të*

autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se me rastin e heshtjes administrative ndaj kërkesës së ankueses për të caktuar të njëjtën ushtruese e detyrës së Drejtorit të Departamentit për Hartimin e Politikave dhe Zhvillim Ekonomik të Komuniteteve, të njëjtës nuk i’u ka cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e saj e punës, andaj, e njëjta nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.167/2026 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës siç parashihet me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.167/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses D.T-H;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Arkivit të KPMSHCK-së.